



REPUBLIK ÖSTERREICH
Parlament

Roli në Rritje i Zyrave Parlamentare të Buxhetit ne Qeverisjen Fiskale

Shembulli i Austrisë

Joint Vienna Institute, 11 qershor 2018

Helmut Berger
Zyra e Buxhetit e Parlamentit të Austrisë

PROGRAMI

- Institucionet e Pavarura Fiskale
- Ngritja e PBO-së austriake
- Funksione specifike në kontekst specifik
- Kontributi i PBO-së në Debatin Parlamentar



INSTITUCIONET E PAVARURA FISKALE



PËRKUFIZIMI I INSTITUCIONEVE TË PAVARURA FISKALE

Institucionet e pavarura fiskale (zakonisht të quajtura si zyrat e pavarura parlamentare të buxhetit ose këshillat fiskalë) janë

- institucione publike të pavarura
- nën pushtetin statutor të ekzekutivit ose të legjislativit
- të cilat ofrojnë mbikëqyrje dhe analiza jo-të partishme
- për politikën dhe ecurinë fiskale dhe, në disa raste, edhe këshillime për to.

Thelbësor për këtë përkufizim është fakti se IFI-t kanë një detyrë diagnostike që shqyrton të kaluarën (ex ante) por që vështron nga e ardhmja (forward looking).




DETYRAT THEMELORE

- Ofron mbikëqyrje për ecurinë fiskale
- Mbështet ligjvënësin në analiza buxheti
- Monitoron ose vlerëson pajtueshmërinë me rregullat/objektivat fiskale
- Përgatit ose vlerëson parashikimet makroekonomike dhe fiskale
- Kryen analiza buxhetore dhe fiskale dhe/ose ofron këshilla publike për çështje buxhetore ose fiskale
- Vlerësime të mëpasme (ex-post) ose të përparme (ex-ante) të politikave fiskale
- Vlerëson qëndrueshmërinë afatgjatë fiskale
- Përgatit analiza të kostos së politikave (policy costing) ose ofron mbikëqyrje të pavarur të tyre.
- Kostoja e platformave të zgjedhjeve (programet)



MODELE DHE PARIME THEMELORE

- Zyrat Buxhetore Parlamentare
- Këshillat Fiskale
- Njësi të pavarura brenda SAI-t



MODELET THEMELORE

- Modeli i Zyrës Buxhetore Parlamentare
 - Përqendrohet në mbështetjen e mbikëqyrjes parlamentare
 - Mbështet komitetet kryesore të buxhetit
 - Redukton asimetritë në informacionin tek qeveria
 - Shpesh rol për analizë kostoje
- Modeli i Këshillit Fiskal
 - Nën autoritetin ekzekutiv ose të vijave të dyfishta të llogaridhënies
 - Ose këshilla të vogla kryesisht akademik,e ose këshilla me anëtarë të propozuar nga palë ose grupe të ndryshme interesi
 - Shkallë të ndryshme të pavarësisë institucionale
- Modele të tjera
 - Të lidhura me Institucionin e Epërm të Auditimit
 - Bordi Fiskal European është IFI i parë supranacional



PARIMET E OECD-SË

Më 13 shkurt 2014 Këshilli i OECD-së miratoi ***Rekomandimet e Këshillit për Parimet e Institucioneve të Pavarura Fiskale***. 22 Parimet mbulojnë:

- Pronësinë vendase
- Pavarësinë dhe jo-partishmërinë
- Mandatin
- Burimet
- Marrëdhëniet me ligjvënësit
- Qasjen tek informacioni
- Transparencën
- Komunikimet
- Vlerësimet e jashtme




ELEMENTE TË REJA TË QEVERISË FISKALE

Institucionet e Pavarura Fiskale

- nxitet transparencë dhe llogaridhënie më e madhe fiskale
- rritet cilësia e debatit publik për politikat fiskale
- janë mekanizëm për të ndihmuar se si të trajtohet njëanshmëria ndaj shpenzimeve dhe deficitit
- rritet fleksibiliteti për buxhetin kombëtar
- forcohet disiplina fiskale (sidomos në përputhje me rregullat e besueshme fiskale),
- i bashkëngjitet qëndrueshmërisë afatgjatë dhe mbarështimit të rreziqeve fiskale
- këqyren si partnerë të rëndësishëm për ministritë e financave dhe komitetet legislative buxhetore për nxitjen e politikave të besueshme fiskale




INSTITUCIONET E PAVARURA FISKALE NË VENDET E OECD-SË



MBËSHTETJE E KONTROLLIT BUXHETOR TË PARLAMENTEVE NË VENDET ANËTARE TË OECD-SË

- Biblioteka/ personeli i Komitetit dhe shërbimet kërkimore (tradicionale)
- Njësi të specializuara të brendshme (p.sh. në Britaninë e Madhe, Izrael, Poloni)
- Zyra të pavarura parlamentare buxheti (p.sh. në SHBA, Kore, Itali)



NGRITJA E PBO-SË AUSTRIAKE



PËRCAKTIMI I KONTEKSTIT SISTEMI POLITIK DHE FISKAL AUSTRIAK



- Republika e Austrisë është shtet federal i përbërë nga nëntë provinca federale autonome, të ashtuquajturat "Laender"
- Pushtetet legjislative dhe ekzekutive ndahen midis parlamenteve dhe qeverive federale dhe provinciale
- Megjithatë, pushtetet legjislative dhe fiskale janë tejet të centralizuara
- Në nivel vendor të drejtën për t'u vetëqeverisur e ushtrojnë 2100 bashki.



PËRCAKTIMI I KONTEKSTIT PARLAMENTI I AUSTRISË



- Austria është **demokraci parlamentare**, sistemi zgjedhor mbështetet në përfaqësimin përpjesëtimor
- Parlamenti është **bikameral**, ku njëra dhomë është mbizotëruese - Këshilli Kombëtar (Nationalrat - 183 anëtarë) dhe Këshilli Federal (Bundersrat, 62 anëtarë)
- Këshilli Kombëtar ka **kompetenca ekskluzive** në çështje buxhetore
- Në Këshillin Kombëtar përfaqësohen pesë grupe parlamentare
- Qysh nga viti 1945 sistemi politik austriak dominohet nga qeveri të shumicës dhe zakonisht nga koalicione të gjera të dy partive kryesore.
- Aktualisht koalicioni është ndërtuar nga Partia Popullore e Austrisë dhe Partia Austriake e Lirisë (koalicioni i qendrës së djathtë)




REFORMA BUXHETORE SI ELEMENT KATALIZATOR PËR ZYRËN PARLAMENTARE TË BUXHETIT

Sfondi politik dhe objektivat:

- Dijenitë fiskale dhe ekspertiza teknike ishte e përqendruar së tepërmi në nivel qeveritar
- Asimetri të theksuara midis Qeverisë dhe Parlamentit (sidomos për pakicën parlamentare dhe grupet e opozitës)
- Përpjekje afatgjata për t'i ofruar Parlamentit ekspertizë buxhetore të menjëhershme dhe të pavarur nga qeveria dhe për të fuqizuar pozitën e saj në lidhje me qeverinë
- Ngritja e PBO-së austriake u lidh mjaft afër me reformën thelbësore të ligjit organik buxhetor, duke ndryshuar elemente të rëndësishme të sistemit buxhetor austriak



PARIMET E LIGJIT TË RI ORGANIK TË BUXHETIT FEDERAL




new budget principles: outcome-orientation; efficiency; transparency; true and fair view

Burimi: BMF



ELEMENTËT E RINJ TË KUADRIT FISKAL AUSTRIAK

- **Kuadri Afatmesëm i Shpenzimeve** Ligjërisht i detyrueshëm për katër vjet (qysh nga viti 2009)
- **Kontabiliteti akrual dhe buxhetimi** në nivelin federal (qysh nga viti 2013)
- **Buxhetimi sipas ecurisë dhe drejtimi sipas rezultateve** i njësive administrative (qysh nga viti 2013)
- **Rregulla të reja për rezervat;** me mundësinë për të bartur fondet e papërdorura në fund të vitit fiskal si rezervë e paalokuar (qysh nga viti 2009)
- **Projeksionet afatgjataqë** mbulojnë një periudhë tridhjetë vjeçare (qysh nga viti 2013)
- **Rregullat Fiskale:** Rregulli për lehtësimin e borxhit federal dhe nën-kombëtar (qysh nga maji 2012)
- **Sisteme tërësore të raportimit** gjatë vitit fiskal për zbatimin e buxhetit dhe rezultatet e ecurisë (qysh nga viti 2013)
- **Vlerësime të impaktit** që janë zgjeruar dukshëm për legjislacionin e ri (qysh nga viti 2013)



SFIDAT PËR PARLAMENTIN

- Ndryshim tërësor i strukturave të buxhetit dhe të mundësive të parlamentit për udhëheqjen dhe kontrollin e procesit buxhetor.
- Buxhetimi aktual dhe i lidhur me ecurinë i mundëson Parlamentit të ushtrojë mbikëqyrje shtesë ndaj buxhetit, por e bën më kompleks procesin buxhetor dhe lyp dije të reja dhe shtesë teknike.
- Buxheti shndërrohet në një dokument planifikues të integruar për informacionin financiar dhe informacionin për impaktin: Jo vetëm vendime për burimet (kush përfiton dhe çfarë përfiton?) por edhe orientimi i burimeve dhe rezultateve (kush përfiton, çfarë përfiton dhe çfarë rezultatesh ka?)
- Parlamenti ka mundësinë që të diskutojë dhe të ngrejë pyetje për **qasjet strategjike**, objektivat politikë dhe ato të lidhura me rezultatet në debatin në Komitet.
- Kërkon edhe ndryshime kulturore në nivel politik (përcaktimi i përparësive, vendim-marrje transparente etj.)

Nevojitet ripërcaktimi i procedurave të buxhetit dhe i kontrollit të buxhetit në Parlament.



NGRITJA E ZYRËS SË RE PARLAMENTARE TË BUXHETIT

- Ligji i ri për buxhetin njih të drejtën e Parlamentit për çështje buxhetore deri në një nivel më të lartë agregimi (70 buxhete globale në vend të më shumë se sa 1100 linjave individuale buxhetore)
 - Dy elemente të tjera të rëndësishme për fuqizimin e kontrollit parlamentar buxhetor:
 - Kërkesa raportuese shtesë për Ministrin e Financave
 - Ngritja e Zyrës së re të pavarur Parlamentare të Buxhetit si projekt pilot për të
- => ofruar analiza objektive dhe të pavarura nga qeveria
- => mbështetur Parlamentin, sidomos Komitetin e Buxhetit në çështje buxhetore



NGRITJA E ZYRËS SË RE PARLAMENTARE TË BUXHETIT

- **Iniciativa** nga kryetarët për buxhetin të grupeve parlamentare dhe diskutimi për modele, personel dhe mandate të ndryshme
- **Marrëveshje politike** e të gjitha grupeve parlamentare për elementet themelorë të PBO-së së re
- Vendimi unanimit për **Komitetin e Buxhetit** që i kërkon Kryetarit të Parlamentit ngritjen e Zyrës Parlamentare të Buxhetit
- PBO-ja duhet të vihet në punë për momentin pa pasur bazë ligjore specifike
- Komiteti i Buxhetit priste që informacioni i nevojshëm buxhetor t'i ofrohet nga Qeveria mbi bazën e legjislacionit mbështetës ekzistues administrativ
- Në rastin e vështirësive praktike do të mbahet parasysh një rregullore specifike për qasjen ndaj informacionit



DOKUMENTET THEMELORE

- **Marrëveshje politike** midis të gjitha partive politike të përfaqësuara në Kuvendin Kombëtar austriak
- **Deklaratë e Komitetit të Buxhetit** të Parlamentit austriak, 10th nëntor 2011 (1510 d.B. XXIV. GP)
- Sipas Ligjit për Këshillin Udhëzues Fiskal Austriak (monitoron pajtueshmërinë e qeverisë me rregullat fiskale në Austri dhe paraqet rekomandime për Qeverinë dhe Parlamentin për politikën fiskale), Kreu i PBO-së është anëtar konsultativ i Këshillit



ORGANIZIMI

- Ngritja e PBO-së në vitin 2012 nga Kreu i Parlamentit në Organigramë si njësi e Administratës Parlamentare, brenda Departamentit të Shërbimeve Legale, Legjislative dhe Kërkimore
- Megjithatë, PBO-ja ka mandat specifik për të mbështetur dhe këshilluar në mënyrë të pavarur dhe drejtpërdrejtë anëtarët e Parlamentit dhe sidomos Komitetin e Buxhetit
- Kreu i PBO-së bie dakord për një katalog produktesh dhe shërbimesh me krerët e grupeve parlamentare
- Kreu i PBO-së merr pjesë si ekspert në takime të Komitetit të Buxhetit

BURIMET

- Mbulimi me personel, 8 punonjës gjithsej (6 ekspertë nga fusha e akademisë, 2 ndihmës)
- Procedurat e rekrutimit lypin konkurrencë publike
- Kreu i PBO-së u emërua pas seancave dëgjimore dhe konsultimeve me krerët buxhetorë të grupeve parlamentare



PARIMET KRYESORE TË PBO-SË

- **Pavarësia dhe objektiviteti**
- Mbështetja e punës së parlamentit në çështje substantive të miratimit të buxhetit dhe kontrollit të buxhetit dhe duke fuqizuar më tej parlamentarizmin
- Orientimi i të gjitha produkteve dhe shërbimeve drejt detyrave dhe nevojave të Komitetit të Buxhetit
- **Trajtimi i barabartë** dhe distanca e barabartë ndaj **të gjitha partive politike**
- Ecuri e cilësisë së lartë përmes personelit kompetent
- Kontribute për rritjen e llogaridhënies së Qeverisë ndaj Parlamentit dhe Publikut
- Nxitje e transparencës fiskale përmes **botimit** të të gjitha rezultateve dhe produkteve në **faqen e internetit të Parlamentit**





FUNKSIONE SPECIFIKE NË KONTEKST SPECIFIK



AKTORËT KRYESORË TË QEVERISJES FISKALE

Bashkimi European (Këshilli dhe Komisioni)



KUADRI PËR PËRCAKTIMIN E FUNKSIONEVE

- PBO-ja është instrument i Parlamentit dhe i lidhur me punën parlamentare
- Procedurat për hartimin e buxhetit përqendrohen kryesisht tek Ministria e Financave dhe Qeveria
- Komiteti i Buxhetit luan rol të rëndësishëm në ushtrimin e kontrollit (buxhetor) parlamentar dhe në ushtrimin e llogaridhënies ndaj Qeverisë në përgjithësi
- PBO-ja nuk ofron shërbime individuale për grupet parlamentare deputetët, por mbështet të tërësi Komitetin e Buxhetit dhe Këshillin e Kombëtar
- Funkcionet e PBO-së përkufizohen në lidhje me ndryshimet nga ligji i ri organik i buxhetit dhe sfidat e reja për Parlamentin
- PBO ishte lojtari i ri në fushë, në një mjedis institucional të mirë-përcaktuar me funksione tradicionale lidhur me procesin buxhetor



MANDATI

- (1) Mbështetja e Komitetit të Buxhetit në trajtën e ekspertizës me shkrim, analizave dhe studimeve të shkurtra për çështje buxhetore të paraqitura nga qeveria sipas Ligjit Organik për Buxhetin Federal (p.sh. projekt-kuadri dhe projekt-buxheti fiskal, raporte)
- (2) Përgatitja e informacioneve dhe analizave të shkurtra me kërkesë të anëtarëve të Komitetit të Buxhetit
- (3) Mbështetja e komiteteve të tjera parlamentare për vlerësimin e impaktit të legjislacionit të ri
- (4) Konsultimi i Parlamentit për ecurinë e procesit të buxhetimit dhe barazinë efektive të grave dhe burrave (buxhetimi i gjinisë)



KATALOGU I PRODUKTEVE & SHËRBIMEVE (I)

Analiza në vijim:

Ekspertizë, analizë dhe studime të shkurtra me shkrim për të gjitha projekt-dokumentet që lidhen me buxhetin të paraqitura nga Qeveria, sidomos

- Kuadri Afatmesëm i Shpenzimeve dhe Ligji Vjetor Federal Financiar
- Projekt-dokumente në lidhje me kërkesat e Semestrit European dhe Sistemit European të Kontrollit të Buxhetit
- Pakti austriak i Stabilitetit dhe Ligji për Barazinë Fiskale
- Raporte për ekzekutimin e buxhetit (muajore) dhe raporte për kontrollin e buxhetit (me parashikim për vitin fiskal)
- Raporte për kontrollin e investimeve (ndërmarrjet publike)
- Raporte për kontrollin e ecurisë dhe të rezultateve
- Raportet për subvencionet, Raportet për huamarrjen, marrjen përsipër të pasiveve, marrëveshjet për borxhin financiar dhe shkëmbimin e valutës



KATALOGU I PRODUKTEVE & SHËRBIMEVE (II)

Analiza të kryera me kërkesë:

- Përgjigjet ndaj pyetjeve lidhur me buxhetin nga Komiteti i Buxhetit ose anëtarët e tij
 - Deklarata apo studime të shkurtra
 - Përgjigje sipas rendit të mbërritjes së kërkesave dhe në varësi të kapacitetit të personelit

Analiza të ndërmarra me nismën e vetë Komitetit:

- Analiza për disa çështje relevante të buxhetit
- Komentë për vlerësimin e impaktit, sidomos rrjedhimet financiare për legjislacionin e ri



KATALOGU I PRODUKTEVE & SHËRBIMEVE (III)

Rekomandimet për përmirësimin e raporteve dhe dokumenteve të buxhetit dhe për zhvillimin e ligjeve organike të buxhetit:

- Pjesëmarrje në vlerësimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të Ligjit Federal Organik të Buxhetit
- Ofrohen sugjerime për Komitetin e Buxhetit lidhur me përmirësimin e mëtejshëm të dokumenteve dhe raporteve të buxhetit
- Shërbime konsulence për ecurinë dhe buxhetin gjinor
- Konsultime lidhur me vlerësimin e impaktit të legjislacionit të ri sikurse kërkohet nga anëtarët.



KATALOGU I PRODUKTEVE & SHËRBIMEVE (III)

Ndërtimi i rrjeteve për transferimin e informacionit dhe dijes:

- Shkëmbim informacioni me palët përkatëse të interesuara (Ministritë, Gjykatën e Auditimit të Austrisë, Statistikat e Austrisë)
- Pjesëmarrje në Këshillin Konsultativ Fiskal (analizon financat publike dhe paraqet rekomandime për politikat fiskale; PBO-ja dhe Banka Kombëtare e Austrisë marrin pjesë në funksion konsultativ)
- Ngritja e rrjetit me institucione shkencore (p.sh. Instituti Austriak i Kërkimeve Ekonomike, Instituti i Studimeve të Përparuara)
- Bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë (Banka Botërore, OECD, Rrjeti i Zyrtarëve Parlamentarë të Buxhetit, Institucionet e BE-së, FMN-ja, Universitete)
- Transferim i dijes dhe informacionit (p.sh. prezantime, seanca dëgjimore të ekspertëve, botime) brenda dhe jashtë Parlamentit
- Botimi i të gjitha rezultateve në faqen e internetit të Parlamentit


[Link Budgetdienst](#)



INPUTI I PBO-SË NË DEBATIN PARLAMENTAR



SHQYRTIMI DHE MIRATIMI I BUXHETIT - PËRMBLEDHJE



KOMITETI I BUXHETIT

- Komiteti i Buxhetit përgatit miratimin e MTEF-së, të Ligjit Federal të Financave, dhe të gjitha llojet e ligjeve për çështje buxhetore. Mban debat gjithashtu edhe për Deklaratat Federale Financiare
- Gjatë debatit të projekt buxhetit Ministri i Financave ose Ministri përgjegjës i Linjës duhet të jenë të pranishëm dhe t'u përgjigjen të gjitha pyetjeve që mund të ngrihen lidhur me alokimet në buxhet
- Sa i takon zbatimit të Ligjit të Financimit të Buxhetit, Komiteti i Buxhetit diskuton dhe zgjidh gjithashtu të ashtuquajturit Ligje Shoqëruese të Buxhetit (Budgetbegleitgesetze). Këto Ligje Shoqëruese të Buxhetit e ndryshojnë legjislacionin në çështje të ndryshme me impakt financiar, sikurse janë, për shembull, ligjet për grantet familjare, sigurimet shoqërore ose financimin e spitaleve.



PROCEDURAT E KOMITETIT GJATË DEBATIT TË BUXHETIT

- Komiteti i Buxhetit gjithmonë mban **seanca dëgjimore publike me ekspertë** të emëruar nga grupet parlamentare
- PBO harton analiza për buxhetin në përgjithësi dhe për secilin kapitull të buxhetit
- Gjatë përafërsisht 5 ditëve të ardhshme komiteti mban **debate individuale për secilin kapitull buxhetor** (jo publik)



- Përveç anëtarëve të vet të përhershëm të Komitetit Buxhetor, ose si zëvendësues të tyre, grupet parlamentare emërojnë **anëtarë me përvojë në fushat e politikave** që lidhen me secilin kapitull buxhetor
- Komiteti mund të **ndryshojë** projekt buxhetin në çdo formë
- POR: përgjithësisht vetëm një numër i vogël alokimesh në buxhet ndryshohen nga Parlamenti



MBLEDHJET E RREGULLTA TË KOMITETIT TË BUXHETIT

- Tematika në programin e takimeve të rregullta, për shembull
 - Raportet për ekzekutimin e buxhetit korrent (p.sh. kontrolli mbi buxhetin, ekzekutimi mujor i buxhetit)
 - Raporte për rezultatet dhe vlerësimet e përparshme të impaktit
 - Legjislacion i ri i caktuar për komitetin e buxhetit
 - Projekt dokumente lidhur me Semestrin Europian (p.sh. Programin Austriak të Stabilitetit, Programin Kombëtar të Reformave)
- Zyra e Buxhetit harton analiza të shkurtra për dokumentet që janë në agjendë të takimeve të rregullta
- Kreu i Zyrës së Buxhetit merr pjesë gjithmonë në takimet dhe mund të këshillohet për rolin e vet si ekspert



KONTRIBUTI NGA PBO (I)

Rritja e ndërgjegjësimit të të gjitha palëve të interesuara dhe shërbimeve të konsulencës për Komitetin e Buxhetit sidomos lidhur me

- Analizat e zhvillimeve makroekonomike dhe qëndrueshmërisë fiskale (p.sh. zbatimin e risqeve për kuadrin e shpenzimeve)
- Analizat e ndryshimeve për strukturën e shpenzimeve dhe të të ardhurave
- Analizat e ndryshimeve për strukturën tatimore
- Analizat e efekteve shpërndarës të një reforme kryesore tatimore duke përdorur mjete mikrosimulimi
- Propozimi i përmirësimeve në organizimin e dokumenteve buxhetore
- Rekomandimi i përmirësimeve të raporteve të paraqitura nga Qeveria (p.sh. raportet e subvencionimeve)
- Kontribut në këndvështrimin e përdoruesit të Parlamentit për vlerësimin e reformës juridike buxhetore



KONTRIBUTI NGA PBO (II)

Shërbimet e konsulencës për Komitetin e Buxhetit sidomos lidhur me ecurinë e çështjeve të buxhetimit dhe gjinore

- Ndërtimi i hartave me një pamje të përgjithshme të informacionit të ecurisë (objektivat, masat dhe treguesit) për përmirësimin e transparencës
- Ofrimi i informacionit të përgjithshëm për çështje kyçe dhe për problematikën që lidhet me ecurinë e procesit të buxhetimit (p.sh. produktet ndaj rezultateve)
- Analiza për orientimin e rezultateve (p.sh. harmonizimi më i fuqishëm i objektivave midis ministrive të ndryshme të linjës)
- Analiza për buxhetimin gjinor dhe barazinë gjinore (p.sh. të dhëna munguese për disagregimin gjinor ose objektivat ambiciozë, mungesa e bashkëpunimit midis ministrive)
- Kontribut për zhvillimin e mëtejshëm - p.sh. për buxhetin transparent sa i takon diversitetit (duke mbajtur parasysh njerëz me të kaluar ose brezni si emigrantë, persona me aftësi të kufizuara)



BALLAFAQIMI ME SFIDAT

- PBO-ja gjithnjë e më shumë njihet si faktor relevant në procesin e hartimit të buxhetit dhe në debatin për buxhetin
- Pjesëtarët e Parlamentit dhe personeli i tyre mbështetës, por edhe Ministria e Financave dhe Ministritë e Linjës, përdorin intensivisht produkte të PBO-së për përgatitjen e tyre në seancat e Komitetit dhe ato Plenare
- Kërkesat studimore nga anëtarët të Komitetit të Buxhetit marrin rëndësi gjithnjë e më të madhe
- Analizat e PBO-së perceptohen si objektive dhe me cilësi të lartë edhe brenda Njësiqe Qeveritare përkatëse apo nga Media që përdorin këtë informacion në faqen e internetit të Parlamentit
- Marrëdhënie të forta bashkëpunuese janë ndërtuar me njësitë qeveritare që kanë sjellë në transferim të dijes në të dyja drejtimet
- Qasja në informacionin buxhetor funksionin mirë në thelb, por ende në bazë informale dhe mund të qartësohet më tej.
- PBO-ja ndihmon punën e parlamentit, por nuk i drejtohet publikut në mënyrë aktive



JU FALEMNDERIT PËR VËMENDJEN TUAJ!

Kontakti:

Helmut Berger

Shef i Zyrës Buxhetore Parlamentare

Parliament, A-1017 Wien, Dr. Karl Renner-Ring 3

Tel. +0043 1 40 110-2889; +0043 676 8900-2889

E-mail: helmut.berger@parlament.gv.at

